

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Lufta" për pagat e magjistratëve, Kuvendi voton pas mesnatës formulën e re, Rama sfidon Kushtetuese n: S'mund të thuash penalltinë do ta gjuaj unë!
ADRESA	https://newsbomb.al/politike/lufta-per-pagat-e-magjistrateve-kuvendi-voton-pas-mesnates-formulen-e-r-i401502
BURIMI	newsbomb.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 05:22:58 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 05:11:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	670f5b1f967701f98897f3eebc4b588798fa3c4d4686b6fb6a1310059b312306
TEKSTI	b76bc802f93eb6860fc4c856503e8dc819752951039d0dd77a58663d71a29170
PAMJA	525f1aff17207bc08809c134103fa7d42cba7d773893818e3e1e190b9df26239

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	450026a8503d3ef5ac525a09e5f2fe6cbcc2e40d99b78f4f453ace215e4cb14e
E MËPARSHMJA	a8ccf7b27d13f1536570b77cd6a8e62a29fa249da2a9b168dfd336fe35725071
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/450026a8503d3ef5ac525a09e5f2fe6cbcc2e40d99b78f4f453ace215e4cb14e

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

12 numrat e parë FALAS!
Version PDF

Abonohu te Revista

[Kreu](#)
[Politikë](#)
[Aktualitet](#)
[Ekonomi](#)
[Kulturë & Art](#)
[Rajon](#)
[Sport](#)
[Bota](#)
[Showbiz](#)
[SocialBomb](#)


Çështjet kryesore

Haga vendos për katër ish-krerët e UÇK-së!

Arrestohet Ergys Agasi

"Retreat"-i i qeverisë në Pogradec!

Politikë

18 Shtator 2026, 07:11

"Lufta" për pagat e magistratëve, Kuvendi voton pas mesnatës formulën e re, Rama sfidon Kushtetuesen: S'mund të thuash penalltinë do ta gjuaj unë!



Shkruar nga Newsbomb



Fotomontazh-Edi Rama

Në një seancë maratonë e cila zgjati deri pas mesnatës, Kuvendi i Shqipërisë miratoi me 84 vota pro formulën e re për pagat e magistratëve.

"Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar". 84 vota pro, 1 abstenim, 24 kundër."

Megjithatë ky votim mesa duket nuk ka për t'i dhënë fund përplasjes mes qeverisë dhe institucioneve të drejtësisë, pasi parashikon një rritje të pagës me rreth 8,500 lekë. Ndërkohë që magistratët e kanë kundërshtuar këtë formulë më herët dhe se kërkesa e tyre e miratuar edhe nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë, është rreth nëntë herë më e lartë, afro 80 mijë lekë.

Në momentin e votimit, kryeministri Edi Rama ngriti kartonin jeshil, ndërsa ish-kryeministri Sali Berisha nuk ishte prezent. Gjatë debatit Rama u përplas ashpër me opozitën, e cila

Revista



Abonohu tani dhe lexoje >

Lajmet e fundit



Aktualitet

Rriten sërish temperaturat, si do të jetë moti sot



Bota

Von der Leyen dhe Mark Carney sfidojnë Trump, Kanadoja mund të bëhet anëtarja e parë e asociuar e Bashkimit Europian

Zbulo më shumë artikuj >

kishte paralajmëruar votën kundër projektligjit dhe e kishte cilësuar atë një "puç kushtetues".



Momenti i votimit

Kryeministri Rama solli dhe "nevojën urgjente" për një ligj të ri, duke argumentuar se pas reformës në drejtësi, pagat e magistratëve u rritën në mënyrë "stratosferike" dhe se është krijuar një raport që sipas tij tashmë duhet rishikuar.

"Këtu është nevoja për të bërë një ligj të ri, për t'i dhënë fund kësaj historie, e cila e ka zanafillën e vet në atë moment kur, në bërjen e reformës, nuk u përcaktua koha se kur piramida do të balancohej. Nuk u tha qartë dhe nuk u tha troç që ju do të merrni këtë tani nga taksat e shqiptarëve, shumë më tepër se gjithë të tjerët, sepse reforma kërkon nga ju që të bëni një sforco, por ama kjo nuk do të jetë një rritje permanente. Sa herë të rriten të tjerët, do të rriteni edhe ju, sepse i bie pastaj, siç e thashë në fillim, do të krijoni shtetin e parë në botë. Dhe unë i sfidoj të gjithë të më sjellin, të paktën në 2 mijë vjetët e fundit, një sistem ku gjykatësit kanë qenë mbi të gjithë në aspektin e taksave. Nuk ndodh. Është nonsens", tha Rama, teksa më tej bëri me dije se për hartimin e këtij ligji të ri kanë nisur konsultimet me Këshillin e Europës dhe Komisionin European për Eficiencën e Drejtësisë.

"Ne kemi filluar kontaktet me Këshillin e Europës, me atë Komisionin European për Eficiencën e Drejtësisë. Dhe unë i kam pritur të gjithë këta që i kishit ju në komisionin përkatës, sepse kërkuam takim dhe ne e organizuam takimin. E organizuam takimin sipas dëshirës dhe kushteve të tyre, në kuptimin për t'u dhënë të gjithë mundësinë që të flasin, të flasim dhe për t'u thënë që këtu ka një problem, të cilin do ta adresojmë së bashku. Ne nuk mund të shkojmë në një konflikt pushtetesh dhe ne jemi të gatshëm, jo të gatshëm, por jemi tërësisht të angazhuar që të bëjmë një ligj të ri. Ka një sërë mënyrash për ta bërë, por kjo historia që sa herë rritet një pagë në Republikë, duhet rritur një pagë atje, duhet të marrë fund. Kjo është absurde", tha Rama.

Ndërkohë që gjatë fjalës së tij, kryeministri sfidoi dhe Gjykatën Kushtetuese duke i treguar edhe vijën e kuqe. Kreu i qeverisë tha se ajo ka të drejtë të rrëzojë një ligj që bie ndesh me Kushtetutën, por nuk mund t'i diktojë Kuvendit formulën konkrete që duhet të miratojë.

"Gjykata Kushtetuese është arbitri. Ajo mund ta ndalojë lojën, mund të konstatojë shkeljen, mund ta anulojë golin, por nuk mund ta marrë topin dhe të thotë: 'Topi është imi. Penalltinë do ta gjuaj unë', tha Rama.

Çfarë u votua pas mesnatës në Kuvend:

-Projektligji "Për ratifikimin e Konventës për Themelimin e Komisionit Ndërkombëtar të Kërkesave për Ukrainën, bërë në Hagë, më 16.12.2025"- 102 vota pro, 0 abstenim, 0 kundër

-Projektligji "Për ratifikimin e Konventës kuadër të Këshillit të Evropës për Inteligjencën Artificiale, të Drejtat e Njeriut, Demokracinë dhe Shtetin e së Drejtës"- 107 vota pro, 0 abstenim, 0 kundër

-Projektligji "Për pranimin e vendimit DEC-I 1/119-VI/2024, të Këshillit të Anëtarëve të Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit, për ndryshimin e nenit 36 të Marrëveshjes Ndërkombëtare për Vajin e Ullirit dhe Ullinj të Tavolinës, 2015, aderuar me ligjin nr. 112/2017"- 107 vota pro, 0 abstenim, 0 kundër

-Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016, "Për statusin e

gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”. 84 vota pro, 1 abstenim, 24 kundër


Galeria fotografike ()



Sondazh

Poll

Lexo gjithashtu



🕒 E Enjte 23:55

“Sa më shumë i merrni shqiptarët për budallenj, aq më shumë do e hani ballit”, Rama: Subjekti i arbitrazhit do marrë ZERO lekë, paratë e Albcontrol do kthehen në arkën e shtetit



Politikë

Rama bëri lojëra të mëdha me kufijtë e Kosovës, tani lan duart si Ponc Pilati”, Berisha zbulon prapaskenën



Politikë

“I dërgova Trumpit letër dhe ai e lexoi”, Berisha zbulon emrin e kompanisë së lobimit për heqjen e

🕒 E Enjte 22:15

🕒 E Enjte 21:50



🕒 E Enjte 21:26

Ngritja e Gjykatës Speciale që dënoi me 81 vite burg ish-krerët e UÇK-së, Berisha e zbulon për herë të parë: Hillary Clinton ma kërkoi ta mbështesja



Politikë

"Nuk mban më ujë pilafi", Mirela Kumbaro dhe Tërmet Peçi firmosin shkresën për kryetarin e djathtë të Memaliaj: Jemi të shqetësuar për banorët, ti nuk po bën asgjë (VIDEO)

🕒 E Enjte 19:37



Politikë

Taulant Balla publikon VIDEON! Dje i jepte meritat për luftën, kur Sali Berisha "nxinte" Hashim Thaçin: Argat i serbëve! Vrau 200 anëtarë të LDK-së

🕒 E Enjte 17:18



🕒 E Enjte 15:32

"Çfarë duhet të ndodhë, që Jakup Krasniqi të vdesë në burg?" Spiropali e emocionuar, thirrje deputetëve: Të mbështesim financiarisht betejën për mbrojtjen e tyre



Politikë

Shqipëria dënon aktgjykimin e Hagës,
Kuvendi me deklaratë: Lufta e UÇK-së
ishte lufta e një populli për çlirimin

🕒 E Enjte 15:16



Politikë

"Mblidh mendjen e hiq dorë nga
detyra, pi një kafe me Karçanaj!"
Berisha LËVDATA Evis Salës e kritika
Spahiut, ministrja: Keni qenë
profesori im...

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.